



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 23.4.9-2005/14-08

**MONITORIMI I ZOTIMEVE TË BLERËSVE TË NDËRMARRJEVE
SHOQËRORE TË PRIVATIZUARA ME METODËN E SPIN OFF
SPECIAL**

Auditim jo i detyrueshëm

Prishtinë, Dhjetor 2015

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës. Artan Venhari, është duke ushtruar detyrën (UD) e kreut të ZAP-it, i cili ka rreth 145 të punësuar.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga ZAP promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për ti kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

Auditimet e performancës kryhen për të vlerësuar nëse programet qeveritare menaxhohen në mënyrë të duhur, kost-efektive dhe efikase dhe nëse sistemet për matjen dhe raportimin e efikasitetit tyre janë funksionale.

UD i Auditorit të Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me këtë raport të auditimit të performancës për “Monitorimin e Marrëveshje Zotimi të NSH-ve të privatizuara me spin off special” të realizuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), dhe i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti i lëshuar është rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtoreshës së Auditimit, Myrvete Gashi, i mbështetur nga, Fitim Haliti (Udhëheqës Ekipi), Fikret Ibrahimimi dhe Arta Kryeziu (Auditor).

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	i
1 Hyrje	1
1.1 Procesi i privatizimit	1
1.2 Problemi i auditimit.....	1
1.3 Objektiva e auditimit.....	2
1.4 Pyetjet e auditimit.....	2
1.5 Kriteret e auditimit	3
1.6 Fushëveprimi dhe Metodologjia e auditimit	3
2 Përshkrimi i fushës së auditimit	4
2.1 Akterët relevant brenda AKP-së.....	4
2.2 Metodatat e privatizimit	5
3 Të gjeturat e auditimit.....	6
3.1 Si ka qenë i rregulluar monitorimi i kontratave?	7
3.1.1 A ka pasur infrastrukturë ligjore që e rregullon procesin e monitorimit?	7
3.1.2 A ka qenë i vendosur një mekanizim ligjor që garanton se zotimet e marra nga blerësit do të respektohen?	7
3.1.3 A kishte hartuar AKP-ja plan për menaxhimin e monitorimit?	8
3.1.4 A ishte i vendosur një sistem raportimi?.....	9
3.2 Si është monitoruar procesi i përmbushjes së zotimeve?.....	9
3.2.1 A janë arritur objektivat e realizimit të monitorimit kundrejt planifikimit?.....	10
3.2.2 A u morën veprimet nga AKP-ja konform kriterëve që parashihen me “Marrëveshje Zotimi”?	10
3.3 Deri në çfarë niveli janë përmbushur zotimet nga blerësit?	19
4 Konkluzionet	22
5 Rekomandimet	23

Lista e shkurtesave

AKM - Agjensioni Kosovar i Mirëbesimit

AKP - Agjencia Kosovare e Privatizimit

BD - Bordi i Drejtorëve

NSH - Ndërmarrje Shoqërore

NJKM - Njësia për Kontroll dhe Mbikëqyrje

ZAP - Zyra e Auditorit të Përgjithshëm

Përmbledhje e përgjithshme

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP-i) ka kryer auditimin e performancës me fokus monitorimi i zotimeve të kryera nga AKP, zotime të dhëna nga blerësit e Ndërmarrjeve Shoqërore (NSH-ve) të privatizuara. Auditimi është kryer kryesisht në Njësinë për Kontroll dhe Mbikëqyrje (NJKM) sepse ajo është bartësja kryesore në Monitorimin e “Marrëveshje Zotimi”.

Njëra prej metodave të aplikuara gjatë privatizimit të NSH-ve është shitja nëpërmjet spin-off special. Kjo metodë nënkupton shitjen me kushte. Privatizimi i NSH-ve me spin off special ka filluar në vitin 2005 nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) për të vazhduar pas vitit 2008 nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP).

Objektivi i auditimit ka qenë që të vlerësohet se a e ka bërë AKM/AKP-ja në mënyrën e duhur monitorimin e implementimit të zotimeve të bëra nga blerësit e NSH-ve dhe të nxirren mësimë nga ky proces i monitorimit.

Arsyeja e këtij auditimi është se raportet e mëhershme të ZAP-it kanë konstatuar mangësi lidhur me monitorimin e NSH-ve të privatizuara. Po ashtu interesimi i publikut dhe shkrimet e shpeshta për NSH-të e privatizuara i shtojnë rëndësi këtij studimi.

Nga 26 NSH të privatizuara me metodën e spin off special, 9 prej tyre kanë qenë nën hetime gjatë kohës së auditimit, të cilat ne nuk i kemi përfshirë në auditimin tonë.

Të gjeturat e këtij auditimi tregojnë se AKP-ja kishte vendosur kontrole të brendshme dhe rregulloret se si të monitorohet përmbushja e zotimeve të blerësve të NSH-ve të privatizuara me spin-off special. Po ashtu, kishte të dizajnuar një sistem monitorimi, për përcjelljen e përmbushjes së zotimeve.

Të gjeturat më të rëndësishme të auditimit janë si në vijim:

- AKP-ja kishte hartuar Plan Vjetor të Monitorimit por nuk kishte vendosur objektiva në lidhje me monitorimin e plotësimin të Zotimeve;
- Nuk ishin aplikuar ndëshkimet financiare dhe nuk janë përmbushur Zotimet brenda periudhës së Zotimit;
- Lirimi nga Raportimi pa u verifikuar nga auditori i pa varur nëse janë përmbushur Zotimet nga Blerësi; dhe
- Vonesë në tërheqjen e aksioneve për Blerësit që kanë pasur një shkallë të ulët të përmbushjes së Zotimeve.

Konkluzionet

Rregullimi i monitorimit të kontratave të shitjeve

AKP-ja ka të dizajnuar një sistem monitorimi dhe raportimi. Megjithatë, në planet vjetore të aktiviteteve të monitorimit, AKP-ja, nuk ka vendosur objektivat konkrete në harmoni me kontratat e nënshkruara.

Monitorimi i procesit të përmbushjes së Zotimeve të Blerësve

“Marrëveshje Zotimi” nuk parasheh zgjatjen e periudhës së zotimit, mos vënien e ndëshkimeve kur nuk plotësohen zotimet e marra nga blerësit dhe lirimin e blerësve nga zotimet pa u plotësuar në tërësi ato.

NJKM-ja ka monitoruar përmbushjen e Zotimeve dhe ka ndërmarrë veprime, mirëpo Bordi i Drejtorëve (BD) nuk ka miratuar ndëshkimet në rastin e mos përmbushjes së Zotimeve dhe i ka liruar blerësit edhe në rastet kur zotimet nuk janë përmbushur në tërësi. Andaj mund të konkludojmë se mos miratimi i ndëshkimeve dhe lirimi nga zotimet pa u përmbushur ato janë devijime prej kushteve të Marrëveshjes.

Përmbushja e Zotimeve nga Blerësit e NSH-ve të shitura me metodën e spin off-it special

Përmbushja e Zotimeve për Investime nga ana e Blerësve brenda periudhës së Zotuar ishte realizuar në shkallë nën 50%, ndërsa rezultatet e arritura deri më tani pas zgjatjes së periudhës për përmbushje të zotimeve janë afërsisht në masën 70%. Rezultatet e arritura për zotimet për punësim janë të kënaqshme, dhe deri më tani kanë arritur deri në nivelin 96%.

Rekomandimet

Rezultatet tregojnë se ekziston se AKP ka hapësirë për përmirësim në fushën e monitorimit.

Me qëllim të shfrytëzimit të mësimave të nxjerra nga procesi i privatizimit në të ardhmen, ne rekomandojmë:

Bordin e ardhshëm të AKP-së të sigurojë që:

1. Planet vjetore të monitorimit të jenë të lidhura me objektivat konkrete në kontratat e nënshkruara.
2. Procesi i monitorimit të përmbushjes së Zotimeve të plotësohet duke shfrytëzuar fuqishëm masat e përcaktuara në rastet kur kushtet nuk përmbushen siç parashihet me “Marrëveshje Zotimi”.
3. Të shtohet presioni tek Blerësit e Ndërmarrjeve që t’i përmbushin zotimet e bëra dhe që blerësit të lirohen nga këto zotime kur ato të jenë plotësuar tërësisht.

Ne rekomandojmë Qeverinë:

1. Mësimet e nxjerra nga proceset aktuale të monitorimit ti marrë parasysh në proceset e ardhshme të privatizimit.

Përgjigja e Ushtruesit të detyrës (UD) të zëvendës drejtorit menaxhues të AKP-së- auditim jo i detyrueshëm 2015

UD i zëvendës drejtorit menaxhues të AKP-së është pajtuar me të gjitha të gjeturat dhe konkluzionet tona, dhe janë zotuar se do të bëjnë të gjitha përpjekjet për të adresuar rekomandimet e dhëna.

1 Hyrje

1.1 Procesi i privatizimit

Periudha e privatizimit si proces në fillim është menaxhuar nga institucionet ndërkombëtare në Kosovë duke bërë themelimin e Agjencia Kosovare e Mirëbesimit në vitin 2002. Rregullorja¹ që krijoi Agjencinë e autorizonte atë të “administronte”² NSH-të dhe asetet e tyre.

Ky proces deri në Qershor të vitit 2008 ishte udhëhequr nga AKM që ishte pjesë e shtyllës së IV të UNMIK-u. Pas shpalljes së pavarësisë në vitin 2008, përfundon veprimtaria e AKM-së, dhe procesin e privatizimit e vazhdon AKP-ja.

Synimi i procesit të privatizimit të këtyre aseteve ishte që të ketë ndikim pozitiv në ekonominë e vendit dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

1.2 Problemi i auditimit

Njëra nga metodat e shitjes së Ndërmarrjeve të reja ka qenë edhe shitja me spin- off special ku Blerësit kanë pasur detyrime kontraktuese për investime kapitale dhe për punësim. Roli i AKP-së ka qenë monitorimi dhe raportimi për plotësimin e zotimeve sipas “Marrëveshjes së Zotimit” nga ana e Blerësve në rast të shitjes me spin off special.

Monitorimi pas privatizimit është bërë sipas kriterëve të caktuar sipas “Marrëveshjes së Zotimit” që është pjesë e kontratës. Kontrata specifikon të gjitha proceset dhe kriteret, që blerësi i ndërmarrjes së privatizuar duhet t’i përmbushë. Në rast të mos përmbushjes së detyrimeve, këto ndërmarrje sërish kalojnë nën administrimin e AKP-së.

Te ndërmarrjet e privatizuara me metodën e spin off-it special, blerësit duhet të realizojnë investime të reja në shumën e përcaktuar dhe të punësojnë një numër të caktuar punëtorësh sipas “Marrëveshje Zotimi”.

Mos përmbushja e obligimeve të caktuara në kontratë nënkupton punësim dhe investime më të ulëta dhe kjo në mënyrë indirekte ndikon në mos zhvillimin ekonomik.

¹ Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2002/12, me të cilën themelohet Agjencia Kosoovare e Mirëbesimit (AKM).

² Administrimi i referohet çdo veprimi që AKP-ja e konsideronte si të përshtatshëm për të ruajtur ose për të shtuar vlerën.

Në raportet e mëhershme të auditimeve të rregullsisë janë konstatuar dobësi lidhur me monitorimin e NSH-ve të privatizuara. Andaj si motivim për kryerjen e këtij auditimi fillimisht janë marrë parasysh të gjeturat në Raportet e auditimit të ZAP-it se AKP:

- pa bazë ligjore kishte bërë ndryshimin e kushteve të kontratës fillestare për privatizimin me spin-off special;
- mos aplikimin e ndëshkimeve dhe faljen e tyre për disa blerës të cilët nuk i kanë përmbushur zotimet; dhe
- ka bërë vazhdimin e aktiviteteve afariste të blerësit e NSH-ve pa marrëveshje të re.

Pastaj, interesimi në publik dhe shkrimet e shpeshta kritike për NSH-të e privatizuara e që ndërlidhet me monitorimin e tyre e kanë bërë të rëndësishme për ne që të qartësojmë faktet dhe shkaqet e mangësive.³

1.3 Objektiva e auditimit

Objektivi i auditimit ka qenë që të vlerësohet se a e ka bërë AKP-ja në mënyrën e duhur monitorimin e implementimit të zotimeve të bëra nga blerësit e NSH-ve dhe të nxirren mësimet nga ky proces i monitorimit.

1.4 Pyetjet e auditimit

Pyetjet e auditimit janë të formuluar që të ofrojnë përgjigjeje për Monitorimin e Zotimeve të Blerësve të NSH-ve të privatizuara me metodën e spin off special.

Për këtë qëllim është definuar pyetja kryesore e auditimit: **“Si e ka fituar sigurinë AKP-ja se kontratat e privatizimit të NSH-ve me metodën e spin-off special janë (dërguar tek rezultatet e dëshiruara) implementuar”?**

Me qëllim që të lehtësohet analiza e problemit të auditimit, janë formuluar nën pyetjet e auditimit si në vijim:

1. Si ka qenë i rregulluar Monitorimi i kontratave?
2. Si është monitoruar procesi i përmbushjes së zotimeve të blerësve të NSH-ve të privatizuar me spin off special?
3. Deri në çfarë niveli blerësit e NSH-ve të privatizuara me spin off special i kanë përmbushur zotimet në pajtim me Marrëveshjet?

³ <http://gazetajnk.com/?cid=1,987,6778>; <http://www.evropaelire.org/content/article/24556329.html>;
<http://koha.net/?id=8&arkiva=1&l=102693>; <http://kosovalbaner.com/2013/10/vazhdojne-eksperimentet-me-privatizimin-e-ndermarrjeve-ne-kosove/>; <http://botasot.info/ekonomia/51400/iNz93fO/>

1.5 Kriteret e auditimit

Kriteret për Monitorimin e NSH-ve të privatizuara me metodën e spin off-it special, janë definuar në përputhje me pyetjet e auditimit.

Kriteret e auditimit për pyetjen e parë të auditimit të rregullimit të procesit të monitorimit të Marrëveshjeve nënkupton:

- monitorimin e “Marrëveshje Zotimi” nga Blerësit, të bazuara në infrastrukturë të qartë ligjore; dhe
- planin dhe procesin e monitorimit të përshkruar dhe dokumentuar.

Kriteret e auditimit për pyetjen e dytë dhe të tretë të auditimit se si është monitoruar procesi i përmbushjes së Zotimeve nga Blerësit, nënkupton që:

- AKP-ja duhet të përcaktoj objektiva të monitorimit dhe ka bërë matje të realizimit të tyre;
- raportimi nga ana e Blerësve duhet bërë sipas kritereve që parasheh “Marrëveshje Zotimi”;
- AKP-ja duhet të ndërmarrë veprime në përputhje me kriteret që parasheh “Marrëveshje Zotimi”; dhe
- Duhet të ekzistoj një mekanizëm ligjor i dokumentuar.

1.6 Fushëveprimi dhe Metodologjia e auditimit

Fushë veprimi i auditimit është shtrirë në AKP. Periudha kohore ishte 2005-2014, e cila mbulon procesin e monitorimit që nga privatizimet e para të NSH-ve me spin off special.

Të dhënat kuantitative dhe kualitative janë mbledhur nga burime të ndryshme. Metodatat e auditimit janë bazuar kryesisht në analizim dhe rishikim të dokumenteve, dhe intervistimit të palëve relevante.

Metodologjia audituese ka përfshirë këto aktivitete specifike:

- Shikimin e kornizës ligjore;
 - Kryerjen e intervistave me zyrtaret përgjegjës të departamentit të monitorimit;
 - Raportimit të Blerësve,
 - Përcjelljen nga ana e AKP-së për përmbushjen e Zotimeve të Blerësve,
 - Raportet e Auditorit të Pavarur mbi plotësimin e Zotimeve të Blerësve,
 - Raportimet e NJKM-së tek Menaxhmenti Ekzekutiv i AKP-së dhe BD të AKP-së mbi përmbushjen e Zotimeve; dhe
 - Vendimet e BD-së.
-

2 Përshkrimi i fushës së auditimit

NSH-të e Kosovës operonin në një gamë të gjerë sektorësh, duke përfshirë minierat, bujqësinë, prodhimin e ushqimeve, përpunimin e metalit, materialet e ndërtimit, tregtinë, ndërtimin, turizmin, transportin dhe shërbimet.

Punonjësit e ndërmarrjeve, ashtu si dhe komunat, dhe shteti u konsideruan si pronarë të mundshëm të NSH-ve në Kosovë.

Privatizimi është transferimi i pronësisë së ndërmarrjes, në tërësi ose pjesërisht, nga shteti në pronën private, duke mundësuar kështu ndërrimin e pronarit të kapitalit.

Qëllimi i privatizimit është që të rritet efikasiteti i ndërmarrjeve. Privatizimi përdoret si pjesë e reformave ekonomike të një shtetit. Shtetet e përkrahin programin e privatizimit në mënyrë që të zvogëlojnë ngarkesën financiare nga qeveritë e tyre, në mënyrë që të rrisin mirëqenien ekonomike të qytetarëve si dhe në përgjithësi të minimizojnë ndikimin shtetëror në udhëheqjen e ndërmarrjeve.

Prandaj, privatizimi konsiderohet si një instrument politik që shton vlerë në treg.

2.1 Akterët relevant brenda AKP-së

Bordi i Drejtorëve (BD) i AKP-së ka përgjegjësi të përgjithshme për aktivitetet e Agjencisë. Përgjegjësitë e BD ndër të tjera janë miratimi i aktit të themelimit, rregulloreve, politikave financiare dhe auditimit, miratimi i politikave operative etj.

Menaxhmenti Ekzekutiv i AKP-së përbëhet nga Drejtori Menaxhues dhe nga dy Zëvendës drejtorë Menaxhues. Ata ushtrojnë kompetencat e Agjencisë të cilat u janë dhënë atyre nga BD-ja ose nga Ligji i AKP-së. Ata së bashku me Drejtorët e Departamenteve përkatëse punojnë ngushtë lidhur me zhvillimin e strategjisë së privatizimit. Drejtori menaxhues raporton te BD-ja. Ai merr pjesë dhe kontribuon në të gjitha mbledhjet e BD, por pa të drejtë vote.

Njësia e kontrollit dhe mbikëqyrjes (NJKM) - Njësia e monitorimit deri në fund të vitit 2011 ka qenë Njësi në vete në kuadër të Departamentit të Qeverisjes Korporatave të AKP- se. Pas ristrukturimit të bërë në AKP nga janari i vitit 2012 Njësia e Monitorimit inkorporohet në kuadër të Njesisë për Kontroll dhe Mbikëqyrje tek Divizioni i shitjes.

Detyrat kryesore të NJKM-së përfshijnë mbledhjen dhe sistematizimin e raporteve financiare nga NSH-të që administrohen nga AKP-ja si dhe sistematizimin, grumbullimin dhe krahasimin e raporteve financiare që të ruhet dhe të rritet vlera e NSH-ve.

Po ashtu, roli i NJKM-së është monitorimi dhe raportimi për plotësimin e Zotimeve sipas "Marrëveshje Zotimi" nga ana e Blerësve.

2.2 Metodatat e privatizimit

Procesi i privatizimit në Kosovë është bërë duke përdorë metodën e shitjes dhe likuidimit.

1. *Shitja e Ndërmarrjeve Shoqërore*

Në rastin e shitjeve të Ndërmarrjeve të Reja janë përdorur këto metoda të shitjeve:

- Spin Off i rregullt - nënkupton shitjen e NSH-ve pa kushte.
- Spin Off special - nënkupton shitjen e NSH-ve tek investitorët duke i bashkangjitur edhe disa kushte.

Blerësit e Ndërmarrjeve të Reja të privatizuara nëpërmjet kësaj metode duhet t'i mbanin kompanitë në funksionim, të bënin investime dhe të mbanin një numër të caktuar punëtorësh.

Një fitues i spin - off-it special përzgjidhet sipas çmimit të ofruar, si dhe në bazë të pikëve të marra për plotësimin e kriterëve të tjera:

- 50% e pikëve jepeshin për çmimin;
- 25% e pikëve për investimet që do të bëhen;
- 25% e pikëve për punësimin.

2. *Shitja e asetëve gjatë procesit të likuidimit të NSH-ve*

Ky proces bazohet në karakteristikat dhe specifikat e këtij modeli, likuidimi vullnetar i privatizimit lejon një dalje të shpejtë nga tregu i atyre ndërmarrjeve të cilat nuk kanë perspektivë të qartë për të mbijetuar.

AKM si Agjenci e cila është marrë me këtë proces ka aplikuar dy hapa në procesin e privatizimit të NSH-ve.

Në hapin e parë AKM si menaxhuese e të gjitha ndërmarrjeve të sektorit shoqëror, mundësonte që të krijoj një kompani të re - "Ndërmarrja e Re" në formën e shoqërisë aksionare apo Kompanisë me Përgjegjësi të Kufizuar dhe t'i transferoj këto subjekte në kompani të reja, një pjesë e asetëve apo të gjitha, të ndërmarrjes së vjetër. Ndërmarrjet e Reja që krijohen kanë të drejta mbi asetet e NSH-ve të vjetra, por nuk janë përgjegjëse për borxhet apo paditë. Përgjegjësitë do të mbesin tek NSH-të e vjetra, të cilat do të vazhdonin të ekzistonin ligjrisht, por nuk do të funksionon më.

Ndërsa, në hapin e dytë i shet aksionet e Ndërmarrjes së Re, (të cilat Agjencia i mban në mirëbesim) investitorëve privat, qoftë vendor apo huaj. Të ardhurat nga shitjet mbahen në një fond të mirëbesimit, duke pritur zgjidhjen e pretendimeve të kreditorëve.

3 Të gjeturat e auditimit

NSH-të e shitura me këtë metodë janë gjithsej 26, ku 21 kishin kusht investimin dhe punësimin, 4 kanë pasur si kusht vetëm punësimin ndërsa një NSH kishte si kusht qarkullimin mbi një limit të caktuar.

Nga Zotimet janë liruar gjithsejtë 20 blerës prej të cilëve 2 nga AKM-ja dhe 18 nga AKP-ja. Për mos përmbushje të zotimeve 4 ndërmarrje janë kthyer në pronësi të AKP-së, ndërsa 2 ndërmarrje ende janë nën monitorim.

Nga 26 NSH të privatizuara me metodën e spin off special, 9 prej tyre kanë qenë nën hetime gjatë kohës së auditimit, të cilat ne nuk i kemi përfshirë në auditimin tonë.

Tabela në vijim prezanton një pasqyrë të përgjithshme për gjendjen e NSH-ve të privatizuara dhe që janë nën hetime.

Tabela 1: Pasqyrë e përgjithshme të ndërmarrjeve që janë privatizuara dhe nën hetime

Gjendja e Ndërmarrjeve	Numri i Ndërmarrjeve	Nën hetime
Të liruar nga Zotimet	20	4
Kthimi i pronësisë të NSH-ve ⁴	4	3
Ende nën monitorim	2	2

⁴ Në kontratë është specifikuar si Tërheqja e aksioneve

3.1 Si ka qenë i rregulluar monitorimi i kontratave?

Meqë, monitorimi është një instrument për përcjelljen e përmbushjes së kushteve të kontratave nga ana e blerësve të NSH-ve me spin off special, për këtë pyetje kemi trajtuar: infrastrukturën ligjore që e rregullon procesin e monitorimit, mekanizmat ligjor që garanton që zotimet e marra nga blerësit do të respektohen dhe hartimin e planit për menaxhimin e monitorimit.

3.1.1 A ka pasur infrastrukturë ligjore që e rregullon procesin e monitorimit?

Rol kyç në procesin e monitorimit është posedimi i një infrastrukture të qartë ligjore që e rregullon atë proces.

Procesi i Monitorimit të Ndërmarrjeve të shitura me spin off special, ishte i rregulluar me Kontratat e Shitjes. Në pjesën e veçantë të kontratave është edhe “Marrëveshje Zotimi”, në të cilën janë përcaktuar detyrimet kontraktuale për Blerësin dhe AKP-në. Ajo përmban nene që parashohin: monitorimin e zotimeve, veprimet në rast mos përmbushjes së zotimeve, ndërprerja e marrëveshjes dhe zgjidhjet e mos marrëveshjeve. Përveç këtyre me rekomandimin e Auditorit të Përgjithshëm është hartuar në vitin 2014 Udhëzuesi për Monitorim.

3.1.2 A ka qenë i vendosur një mekanizim ligjor që garanton se zotimet e marra nga blerësit do të respektohen?

Ekzistenca e një mekanizimi ligjor për të garantuar se Zotimet e Blerësve do të respektohen është esenciale.

AKP-ja kishte një mekanizëm ligjor që përmbante procesin e monitorimit të Ndërmarrjeve të privatizuara dhe përcaktonte masat ndëshkimore në rast të mos përmbushjes së Zotimeve.

Megjithatë, ne kemi vërejtur se, ky mekanizëm ligjor në raste specifike ka krijuar paqartësitë në vijim:

Definime kontradiktore brenda Kontratës

Paragrafi i rregullimit të çështjes se çka nën kuptohet me investim kapitale sipas opinionit tonë i ka dy definime kontradiktore:

- tek “Marrëveshje Zotimi” garantimi i investimeve duhet të siguroj se investimet kapitale **të zotuar**a që do të bëhet brenda periudhës së zotimit nga hyrja në fuqi e kësaj marrëveshje.
- tek kontrata për qëllimet e kësaj marrëveshje “investimet kapitale” nënkuptojnë **paratë e paguara** për blerje e aseteve kapitale.

Mos përcaktimi i qartë i nivelit të përmbushjes së Zotimeve

Në kontratën e bërë ndërmjet AKM/ AKP-së dhe Blerësve, nuk ishte i qartë kriteri i përfundimit të marrëveshjeve. Sipas tyre marrëveshja përfundon në momentin kur AKM/ AKP-ja e njeh rezultatin si të kënaqshme.

AKM/ AKP në kontratë nuk kishte përcaktuar nivelin e përmbushjes së zotimeve nga ana e blerësit në mënyrë të qartë.

Mos përcaktimi i qartë i nivelit të kërkuar lidhur me përmbushjen e zotimeve, e rritë rrezikun që zotimet të mos përmbushen në tersi dhe nga kjo të mos arrihen rezultatet më të mira nga privatizimi me spin off special.

Strategjia e kombinuar për NSH-të e privatizuara me Spin Off Specila

Kontrata është baza ligjore që garanton se zotimet nga blerësit e NSH-ve do të përmbushen.

AKP-ja në vitin 2009 ka miratuar “Strategjinë e kombinuar për NSH-të e privatizuara me spin off special”. Me këtë strategji përmbushja e Zotimeve ndahet në tre kategori: e para me përmbushje prej 0% - 39%, e dyta 40% - 80% dhe e treta 80% ose më lartë.

Kjo Strategji është aplikuar tek Ndërmarrje pas hyrjes në fuqi të saj, si në zgjatjen e periudhës ashtu edhe me rastin e lirimit të tyre nga monitorimi.

Edhe pse kjo strategji përmban elemente të Kontratës së Shitjes, çdo devijim prej kushteve të “Marrëveshjes së Zotimeve” mund të konsiderohet si veprim diskriminues ndaj ofertuesve tjerë.

3.1.3 A kishte hartuar AKP-ja plan për menaxhimin e monitorimit?

Kontratat e privatizimit përmes metodës së spin-off special të NSH-ve parashohin zotime për përmbushje të investimeve dhe punësimit. Këto kontrata po ashtu parashohin se si dhe në çfarë periudha kohore duhet të përmbushin Zotimet e dhëna blerësit e NSH-ve.

Bazuar në kontrata të privatizimit përmes metodës spin-off special dhe zotimeve që përmbajnë këto kontrata, AKP duhet të hartoj plane konkrete lidhur me mënyrën, frekuencën, dhe resurset e nevojshme për monitorimin e implementimit të këtyre zotimeve.

NJKM-ja në fillim të çdo viti kishte përgatitur planin vjetor të aktivitetit të tyre. Përpos kësaj kishte edhe plane tremujore, mujore dhe javore që përcaktohen për përmbushjen e aktiviteteve të përgjithshme të Njësisë.

Ne kemi gjetur se:

NJKM-ja në planin e monitorimit ka vendosur data por nuk kishte vendosur caqe konkrete të vizitave lidhur me monitorimin e plotësimit të zotimeve.

Mungesa e përcaktimit të caqeve për monitorim të investimeve dhe të punësimit e rritë rrezikun që të mos përmbushen zotimet e premtuara dhe të kontraktuara në kohë.

3.1.4 A ishte i vendosur një sistem raportimi?

Një sistem monitorimi dhe raportimi i mirë dizajnuar duhet të sigurojë monitorim dhe raportimit efektiv.

AKP-ja ka të dizajnuar një sistem raportimi për monitorim. Ky sistem raportimi është i paraparë me “Marrëveshje Zotimi”. Sipas këtij sistemi të monitorimit dhe raportimit:

- Blerësit e NSH-ve të privatizuara me metodën e spin off-it special, janë të obliguar të raportojnë tek NJKM-ja për Zotimet e Përmbushura. Këto raportime janë tremujore përgjatë gjithë Periudhës së Zotimit;
- Zyrtarët e NJKM-së bëjnë vizita monitoruese në ambientet e ndërmarrjes së privatizuar. Qëllimi i vizitës është për të parë nivelin e përmbushjes së zotimeve;
- NJKM-ja duhet të raportoj për procesin e monitorimit tek Menaxhmenti dhe BD. Ndërsa vendimet përfundimtare merren nga BD.

Si pjesë e këtij sistemi të monitorimit, nga viti 2009, me kërkesë të BD është bërë praktikë që në fund të periudhës së paraparë me Marrëveshje të angazhohet një kompani e pavarur e auditimit, për dhënien e opinionit mbi nivelin e përmbushjes së zotimeve.

3.2 Si është monitoruar procesi i përmbushjes së zotimeve?

Ne kemi trajtuar monitorimin kundrejt planifikimit, dhe veprimet të cilat janë marrë në përputhje me kriteret që parashihen me “Marrëveshje Zotimi”, dhe në rast të mos përmbushjes së asaj marrëveshje kthimin e pronësisë së ndërmarrjes.

Ne kemi testuar shtatë ndërmarrje për të trajtuar procesin e monitorimit në tërësi, si dhe pesë Ndërmarrje të tjera për të cilat kemi analizuar lirimin nga Zotimet.

3.2.1 A janë arritur objektivat e realizimit të monitorimit kundrejt planifikimit?

AKP duhet të kryej monitorimin e implementimit të zotimeve me qëllim të siguroj se këto zotime janë kryer me përpikëri sipas kontratave të nënshkruara.

Pas hartimit të planit me caqe konkrete fillohet me realizimin e tij. Me caqe definoohen aktivitetet, rezultatet e pritshme, afatet kohore, mënyra e përcjelljes dhe raportimi mbi rezultatet.

Ne kemi gjetur se:

Në planin e monitorimit NJKM-ja nuk kishte vendosur caqe/objektiva në harmoni me kontratat e nënshkruara nëse janë arritur apo jo. Vizitat e zyrtarëve të NJKM-së nuk kanë pasur efekt ekzekutiv por këto vizita kanë pasur vetëm karakter informues. Raportimet e NJKM-së nuk ishin konsideruar në vendimmarrje nga BD-ja lidhur me realizimin/mosrealizimin e Zotimeve të Blerësve.

Vizitat monitoruese të cilat nuk do të kenë efekt ekzekutiv tek menaxhmenti dhe BD atëherë ato e humbin kuptimin e matjeve nëse zotimet ishin përmbushur.

3.2.2 A u morën veprimet nga AKP-ja konform kriterëve që parashihen me “Marrëveshje Zotimi”?

Rol kyç në monitorimin e përmbushjes së Zotimeve të Blerësve ka NJKM-ja. Edhe pse NJKM-ja është bartëse e proceseve të monitorimit, marrja e veprimeve kundrejt kriterëve që parashihen me Marrëveshje nuk është përgjegjësi vetëm e NJKM-së, sepse konkluzionet jepen edhe nga Menaxhmenti dhe vendimet përfundimtare merren nga BD-ja.

Që privatizimi i NSH-ve të implementohet siç është parashikuar me marrëveshje secili duhet të luajë rolin e vet – NJKM-ja, Menaxhmenti Ekzekutiv, Bordi i Drejtorëve si dhe Blerësit.

Në tabelën në vijim janë prezantuar proceset më të rëndësishme, që NJKM-ja , menaxhmenti dhe BD i kanë kryer lidhur me monitorimin e përmbushjes së zotimeve.

Tabela 2: Proceset e monitorimit të përmbushjes së zotimeve

	Përshkrimi i aktivitetit	Rezultatet e pritshme nga këto aktivitete	Përgjegjësitë
A	Njoftimi i Blerësve mbi monitorimin që do të bëhet	Qartësimi i përgjegjësive të Blerësve në përputhje me kontratën	NJKM-ja njofton Blerësit mbi obligimet e marra me rastin e privatizimit.
B	Pranimi i raporteve nga Blerësit dhe vendimmarrja në lidhje me to	Informimi me kohë dhe vendim marrja me kohë. Pranimi i raporteve brenda afatit të caktuar	Verifikimi dhe analizimi i raporteve nga ana NJKM-së të dorëzuara nga Blerësit.
C	Realizimi i vizitave monitoruese	Respektimi i afatit kohor dhe kualiteti i vizitës bazuar në planin	Kryerja e vizitave tek Blerësit pas raportimeve të tyre në NJKM
D	Përpilimi i raporteve	Qartësia dhe përmbajtja e Raportit për vendim marrje në të ardhmen	Hartimi i raportit nga NJKM mbi vizitën e bërë me të dhëna narrative dhe numerike. Dorëzimi i raporteve tek menaxhmenti.
E	Regjistrimi dhe përpunimi i të dhënave	Regjistrimi i të dhënave me kohë dhe saktësi dhe përcjellja se a ka përmbajtje në përputhje me kërkesat.	Verifikimi i faturave për investime kapitale nga NJKM me pagesat e bëra dhe verifikimi i listave të të punësuarve me pagesat e tatimeve dhe kontributeve. Regjistrimi i këtyre të dhënave në database.
F	Planifikimi dhe propozimi për angazhimin e auditorëve të pavarur	Marrja e vendimeve me kohë për angazhimin e auditorëve të pavarur.	Angazhimi me kohë i auditorit të pavarur, përgatitja e Memos për menaxhmentin dhe Bordin lidhur me të gjeturat për përmbushjen e zotimeve.
G	Përpilimi i memove informuese për përmbushjen e Zotimeve tek Menaxhmenti Ekzekutiv dhe BD.	Qartësi dhe përmbajtje e memorandumeve informuese	Përgatitja e memove informuese për përmbushjen e zotimeve nga NJKM.
H	Lirimi nga Zotimet	Zotimet e plotësuara sipas "Marrëveshje Zotimi"	Përgatitja e memove nga NJKM me rezultate ku i propozon menaxhmentit dhe Bordit për lirin e ndërmarrjes nga marrëveshja. Vendimi merret nga BD.

Duke analizuar rezultatet dhe dokumentet e pranuar ne do të shpalojmë të gjeturat tona dhe veprimet që NJKM ka bërë gjatë procesit të monitorimit.

A. Njoftimi i Blerësve mbi monitorimin që do të bëhet

Për çdo monitorim të Ndërmarrjes, NJKM-ja duhet të bëjë njoftimin për monitorimin dhe të qartësojë përgjegjësitë e Blerësve në përputhje me kontratën e nënshkruar dhe në të cilën parashihen zotimet. Me këtë njoftim Blerësi informohet mbi obligimet e marra me rastin e privatizimit, periudhën e monitorimit, dhe mënyrën e raportimit. Ne kemi konstatuar se NJKM ka njoftuar me kohë Blerësit mbi monitorimin.

Transferimi i pronësisë pa miratimin paraprak të BD të AKM-së

Për sa kohë që zgjat “Marrëveshje Zotimi”, as Blerësi dhe as Ndërmarrja nuk mundën, pa miratimin paraprak me shkrim të AKM-së të ndryshojë Pronarët Përfitues apo Personat Kontrollues për Blerësin apo të ndryshojë strukturën e pronësisë së Ndërmarrjes.

Ne kemi gjetur se: Blerësi i NSH-së Kosovatex kishte bërë transferimin e aksioneve tek një Blerës tjetër pa miratimin paraprak të AKM-së. AKM-ja kishte nënshkruar marrëveshjen për transferimin e aksioneve ndërmjet Blerësve dy muaj pas kontratës. BD-ja nuk kishte ndërmarrë kurrfarë masash lidhur me respektimin e plotë të të gjitha kriterëve të kontratës. Ndërrimi i Blerësve gjatë periudhës kur kontraktori nuk i kishte përmbushur zotimet e rritë rrezikun që të mos arrihen objektivat e privatizimit.

B. Pranimi i raporteve nga Blerësit

NJKM-ja në përputhje me “Marrëveshje Zotimi” pranon raportet nga Blerësit. Në rastet kur Blerësi nuk raporton me kohë, atëherë NJKM-ja duhet të kërkojë dorëzimin e raportit mbi ecurinë e zotimeve të marra.

Testet tona tregojnë se NJKM-ja me kohë kërkon nga Blerësit që të raportojnë mbi ecurinë e përmbushjes së zotimeve, po ashtu edhe blerësit e NSH-ve kanë raportuar me kohë për secilën periudhë raportuese.

C. Realizimi i vizitave monitoruese

Vizitat janë të parapara të bëhen pas raportimit të Blerësve mbi ecurinë e përmbushjes së zotimeve.

Pas trajtimit të këtij procesi nga ana e jonë, ne mund të konkludojmë se, pas raportimeve të Blerësve zyrtarët e NJKM-së kanë realizuar vizita për të parë përmbushjen e zotimeve për periudhën përkatëse raportuese.

D. Përpilimi i raporteve

Zyrtarët e NJKM-së duhet të përpilojnë raporte mbi vizitat e bëra tek ndërmarrjet dhe të njoftohet menaxhmenti për to.

Testet tona tregojnë se raportet për vizitat janë hartuar me kohë. Këto raporte përmbajnë informata përshkruese dhe numerike mbi përmbushjen e zotimeve apo edhe për ndonjë kërkesë të Blerësit.

E. Regjistrimi dhe përpunimi i të dhënave

Secili Blerës duhet të raportojë në mënyrë të saktë dhe me kohë siç është paraparë me "Marrëveshje Zotimi". Detyrë e NJKM-së është që ti verifikojë faturat e investimeve kapitale me pagesat e bëra dhe të verifikojë listat e të punësuarve me pagesat e tatimeve dhe kontributeve pensionale.

Nga ky proces monitorimi ne mund të konkludojmë se zyrtarët e NJKM-së i fusin këto të dhëna në bazën e të dhënave dhe në fund të periudhës raportuese të Blerësit i krahasojnë me raportet e auditorit të pavarur.

F. Planifikimi dhe angazhimi i auditorëve të pavarur për të verifikuar përmbushjen e zotimeve sipas "Marrëveshje Zotimi"

Planifikimi dhe angazhimi i Auditorëve të pavarur bëhet me kërkesë të NJKM-së. Auditorët e pavarur kishin për detyrë të: verifikojnë shumën monetare të secilit investim, një kontroll të plotë të faturave dhe verifikimin e numrit të punonjësve sipas Zotimeve të Blerësve të bëra me "Marrëveshje Zotimi".

Auditorët e pavarur kanë dorëzuar me kohë tek NJKM-ja raportet audituese. Bazuar në këto raporte NJKM-ja ka përgatitë Memo për menaxhmentin dhe BD lidhur me të gjeturat respektivisht nivelin e përmbushjes së Zotimeve.

Ne kemi trajtuar ato Memo dhe rezultojnë këto të gjetura:

Vlerësimi i Investimeve Kapitale nga kompania vlerësuese nuk është në përputhje me Rregullat e Tenderit

Sipas Rregullave të Tenderit, "Investimet kapitale" nënkupton paratë e paguara për blerjen e aseteve kapitale dhe themelore, ku përfshihen: e gjithë prona e prekshme e cila nuk mundet që me lehtësi të konvertohet në para të gatshme dhe e cila zakonisht mbahet për një periudhë më të gjatë.

Auditori i Pavarur sipas Raportit të Auditimit për përmbushjen e Zotimeve tek Ndërmarrje e Re "Mulliri Fushë Kosovë" nuk ka qenë në gjendje të konstatojë se faturat paraqesin vlerën reale të pajisjeve (aseteve) të blera. Si pas këtij raporti realizimi i këtyre investimeve kundrejt zotimit është në shkallën 96.14%. Ai rekomandon që të bëhet vlerësimi i këtyre aseteve. Si rrjedhojë e pamundësisë së vërtetimit nga auditori i pavarur se a janë plotësuar investimet, AKP-ja ka angazhuar kompaninë vlerësuese me qëllim të konstatimit të vlerës reale të pajisjeve. Sipas

Raportit të Vlerësimit të Aseteve, Blerësi ka përmbushur Zotimet në masën prej 94.78% dhe është liruar nga zotimet.

Por, ky fakt i vlerësimit të pajisjeve nuk është në përputhje me Rregullat e Tenderit dhe Kontratat e Shitjes, që sipas tyre, "Investime kapitale" do të konsiderohen ato investime për të cilat janë bëra pagesa për blerjen e asetëve kapitale dhe themelore.

Jo konsistencë në vendimmarrje nga BD lidhur me lirimet nga zotimet

Për të verifikuar Zotimet e Blerësit të NSH-së Ndërmarrja e Re "Depo Mulliri Sillosi", AKM-ja ishte mbështetur në raportin e auditorit të pavarur për një periudhë 18 mujore ndërsa për periudhën e mbetur 3 mujore ka angazhuar auditorët e brendshëm (AB) të sajë. Sipas AB Zotimet për investime nuk ishin përmbushur 14%. AB i AKM-së koston e huamarrjes nuk e ka njohur si shpenzime kapitale. Për më tepër, BD-ja nuk kishte aprovuar aplikimin e ndëshkimeve financiare të shqiptuara nga NJKM-ja për mos implementimin e Zotimeve.

BD i AKM-së në mbledhjen e tij të datës 21 Maj 2008 merr vendim për lirim nga kushtet e "Marrëveshje Zotimi" pa u siguruar se janë përmbushur në tërësi ato. Megjithatë në Maj të vitit 2009, AKP-ja, në bazë të vendimit të BD për anulimin e njoftimit për lirim, njofton Blerësin mbi anulimin e bërë dhe auditimin e ri të Zotimeve. Ky auditim i ri për përmbushjen e Zotimeve nuk ka përfunduar sepse auditori ka pasur kufizim të fushëveprimit nga Blerësi, i cili nuk ndihet i obliguar të pranoj auditim tjetër pas marrjes së njoftimit për lirim. Pas negociatave ndërmjet dy palëve, BD i AKP-së në Mars të vitit 2011, prapë merr vendim për të shpall të pa vlefshëm njoftimin për lirim nga kushtet e Marrëveshjes. Auditori i pavarur i angazhuar verifikon investimet e bëra në masën prej 91.15%, ndërsa për punësim 100% brenda periudhës së zotuar, e që deri në fund të vitit 2011 kjo shkallë e punësimit ishte ulur gradualisht nën 55.12%.

Nga kjo mund të konkludojmë se AKM/AKP-ja nuk e ka definuar se kosto e huamarrjes do të jetë i pranuar si investim kapital apo jo.

Përmbushja e zotimeve është pranuar nga auditori i pavarur pas skadimit të periudhës së aprovuar

Përmbushja e Zotimeve, për investime, nga Blerësi i NSH-së "KosovateX" brenda periudhës së Zotuar ishte 0.67%.

Edhe përkundër raportimeve të vazhdueshme se shkelja e "Marrëveshjes së Zotimeve" ishte shkelje e rëndë, AKP-ja nuk kishte marrë asnjë masë të paraparë me kontratë për tërheqjen e pronësisë.

Blerësi kishte ndërruar planin e biznesit pas dështimit për të implementuar planin e parë. Ky plan ishte aprovuar nga BD-ja bashkë me zgjatjen e periudhës së Zotimeve.

Për më tepër, vazhdimi i periudhës së Zotimeve ishte vendosur që të jetë 24 muaj shtesë respektivisht deri më 31/08/2010. Deri në këtë periudhë përmbushja e Zotimeve sipas auditorit të pavarur ishte 46.60% për investime dhe 47% për punësim.

Përkundër kësaj ishte angazhuar edhe një auditim tjetër i pavarur nga AKP që i referohet periudhës deri në Maj të vitit 2011, e cila periudhë e dytë e zgjatjes, përmban edhe 5 muaj të cilët nuk ishin miratuar nga BD-ja. Auditori i pavarur kishte konstatuar përmbushjen e zotimeve 101.84 % për investime dhe 114.5 % për punësim.

Mungesa e veprimeve të parapara sipas Kontratës në rast të shkeljeve të rënda e rritë rrezikun që të humben asetet dhe të mos arrihen objektivat e privatizimit. Zgjatja e afatit për përmbushjen e Zotimeve edhe për periudhën e dytë shtesë, mund të rritë rrezikun që të ndërmerren veprime jashtë Kontratës.

G. Përpilimi i Memove informuese për Menaxhmentin dhe BD

NJKM-ja përpilon Memo informuese për të informuar Menaxhmentin e AKP-së në lidhje me ecurinë e Zotimeve të Blerësve brenda periudhës së Zotimit por edhe në rastet kur ka pasur zgjatje të periudhës deri në lirim nga Zotimet. Në fund të periudhës monitoruese NJKM-ja përgatitë Memo me rezultate ku i propozon menaxhmentit dhe BD-së marrjen e ndonjë vendimi si aplikimin e ndëshkimeve, kthimin e pronësisë, lirim nga zotimet apo situata të tjera.

Ne kemi trajtuar Memot e përpiluara nga NJKM dhe rezultojnë të gjeturat:

Mos aplikimi i ndëshkimeve financiare nga BD për Blerësit të cilët nuk i kanë përmbushur Zotimet brenda periudhës sipas marrëveshjes. Zotimet për investim dhe punësim kanë qenë faktor i rëndësishëm në zgjidhjen e Ofertuesit Fitues. “Marrëveshja e Zotimeve” përmban zotimet të cilat duhet t’i përmbush Blerësi gjatë Periudhës së Zotimit për investime dhe punësim. Në rast se nuk i përmbush plotësisht Zotimet brenda periudhës kohore të specifikuar në “Marrëveshje Zotimi” që është pjesë e Kontratës, do të aplikohen ndëshkimet financiare.

NJKM-ja kishte bërë përllogaritjen e ndëshkimeve financiare dhe për këto kishte njoftuar menaxhmentin e AKP-së dhe Blerësit.

Edhe për kundër faktit se “Marrëveshje Zotimi”, të përkrahur nga opinioni ligjor i Zyrës Ligjore të AKP-së, parashohin përllogaritjen dhe aplikimin e ndëshkimeve financiare në rast të mos përmbushjes së Zotimeve, AKP-ja nuk i ka aplikuar ndëshkimet në ato raste. Arsyeja për këtë sipas AKP-së është mbështetja e tyre në një opinion, i datës 28 Prill 2011, të dhënë nga një ekspert ndërkombëtar, i angazhuar nga AKP-ja, se: “Sipas ligjit anglez, dispozita në kontratë me të cilën kërkohet vënia e sanksioneve ndëshkuese tek pala e cila nuk përmbush detyrimin konsiderohet në kundërshtim me politikën publike, për këtë arsye nuk është i zbatueshëm.”

Tabela në vijim është një përmbledhje që prezanton nivelin e përmbushjes së Zotimeve brenda periudhës së Zotuar dhe përllogaritja e ndëshkimeve financiare. Kjo përmbushje është e konfirmuar sipas Raporteve të Auditorëve të Pavarur të angazhuar nga AKM/ AKP-ja.

Tabela 3: Ndëshkimet financiare

Ndërmarrjet	Periudha e Zotimit	Niveli i përmbushjes brenda periudhës së Zotimit (%) ⁵	Ndëshkimet financiare të përlogaritura
IMK Pipe Factory	20/11/2007-20/11/2009	37 %	1,615,639 €
Mulliri Fushë Kosovë	10/07/2007-10/07/2009	82.70%	1,119,942€
Modeli	13/04/2007-13/04/2009	62.81%	184,584€
Grand Hotel	13/10/2006-12/10/2008	9.84%	8,822,314€
IDGJ Tobacco	14/06/2006-14/08/2008	18.89%	4,573,649€
Xim Strezovci	13/12/2007-13/12/2009	0.96%	7,298,170€
MIM Golesh	11/12/2007-11/12/2009	2.01%	8,447,812€
Agrokosova Holding	27/8/2007-26/08/2009	24.61%	3,579,997€
Llamkos	21/07/2005-20/07/2007	11.10%	1,686,459€

Raportimet nga NJKM tek BD duke u bazuar në Raportimin e Blerësit të Ndërmarrjes

Menaxhmenti i AKP-së për Ndërmarrjen e Re “Ferronkeli”, ka raportuar tek BD se Blerësi ka realizuar investime 59 mil. €, apo 184% më tepër se sa Zotimi. Për këto investime AKP-ja nuk kishte pranuar dëshmi të mjaftueshme se të njëjtat janë investime. Kjo shumë është në bazë të raportimeve të Blerësit në AKP, por në bazë të auditimit të pavarur shuma e verifikuar si investime kapitale është 20 mil. €, e që është përmbushje e Zotimit në shkallën prej 104%.

Për më tepër, BD i AKP-së e kishte liruar nga raportimi Ndërmarrjen e Re “Ferronkeli” edhe pse ky raport i auditimit kishte opinionin e kualifikuar me arsyetimin se: Ndërmarrja nuk mban regjistër ndaras të aseteve fikse. Veç kësaj, auditori i pa varur nuk kishte gjetur dëshmi kontabël të mjaftueshme dhe të duhur, përfshirë bilancin e detajuar vërtetues dhe pasqyrat e nën llogarive në lidhje me investimet dhe transaksionet e kompanisë.

Nga investimet e detajuara të paraqitura në raportin e auditorit të pavarur, vërejmë se totali i investimeve ishte më i lartë për 240,798€ se investimet e tabeluara si investime të pranueshme.

Mos përlogaritja e ndëshkimeve financiare siç parashihet me kontratë për mos përmbushjen zotimit të punësimit.

Nëse në fund të cilësdo periudhë kohore të specifikuar në Marrëveshje, Zotimet për Punësim nuk janë përmbushur në përputhje me këtë Marrëveshje, hyjnë në fuqi dispozitat ndëshkuese.

⁵ Niveli i përmbushjes brenda periudhës së Zotimit nënkupton periudhën e parë sipas Marrëveshjes.

Blerësi i Ndërmarrjes së Re "Ferronikeli", në vitin 2007 në fund të fazës së parë të periudhës së punësimit kishte raportuar mesatarisht 646 punëtor përkundrejt 1,000 punëtorëve sa do duhej të ishin të punësuar, ndërsa ky kriter ishte arritur tre muaj më vonë pas periudhës së zotimeve.

NJKM-ja nuk kishte bërë shqiptimin e ndëshkimeve financiare që në total për tre muaj do të duhej të ishte 265,500€. Mos aplikimi i sanksioneve për arsyen e mos plotësimit të despozicioneve kontraktuale e rritë rrezikun që të mos realizohet investimet sipas kontratës dhe po ashtu të mos arrihen objektivat e privatizimit.

H. Lirimi nga Zotimet e Marrëveshjes

Aty ku në vazhdimësi NJKM-ja ka pranuar raporte cilësore nga ana e Blerësit, por edhe gjatë vizitave tek ata, ka parë përmbushje të zotimeve, pastaj ka verifikuar faturat me pagesa dhe listën e punëtorëve si dhe ka pranuar raportin e auditimit nga auditori i pavarur mbi nivelin e përmbushjes së zotimeve, atëherë propozon për lirimin nga marrëveshja.

Blerësi i Ndërmarrjes lirohet nga Zotimet kur ato përmbushen në tërësi sipas Marrëveshjes.

Tek ky proces ne kemi gjetur se:

Lirimi nga Raportimet pa u konfirmuar Zotimet nga auditorët e pavarur

BD-ja i AKP-së e kishte liruar nga raportimi i mëtejshëm Ndërmarrjen e re "Ferronikeli" shpk katër muaj para se të përfundoj periudha e Zotimit.

BD-ja në mbledhjen e datës 27 dhe 28 shkurt 2009 ka miratuar kërkesën për lirim prej raportimeve për zotime duke u bazuar nga raportimi i menaxhmentit se zotimi për investime ishte plotësuar mbi 300%. Këto investime nuk ishin konfirmuar në këtë kohë nga auditorët e pavarur. Lirimi ishte bërë me një klauzolë se kompania nuk lirohet prej ndonjë përgjegjësie që mund të rezultojë prej auditimit të jashtëm.

Auditori i pavarur ishte angazhuar jo për periudhën e plotë të raportimit por për periudhë tre muaj më të shkurtër se periudha e zotimeve. Ky fakt mund të ndikojë se në datën e përfundimit të periudhës së Zotimit, Zotimi për punësim ishte 1,000 punëtor, gjë që ka mbetur e pa konfirmuar në atë datë.

Për më tepër, AKP-ja nuk kishte pranuar certifikatë për të verifikuar nëse është plotësuar zotimi i tretë për "procesimin e mineraleve". Implementimi i këtij zotimi nuk është trajtuar as në raportin e auditorit të pavarur e nuk kemi vërejtur as nga procesverbalet e mbledhjeve të BD se është diskutuar për të.

Lirimi nga Zotimet para se të përfundoj Periudha e Zotimit e rritë rrezikun që Zotimet e kontraktuara nuk do të përmbushen.

Dëshmi jo të plota për përmbushjen e Zotimit

“Marrëveshje Zotimi” tek disa Ndërmarrje përveç kushteve për investime dhe punësim, përmban edhe ndonjë kusht tjetër shtesë. Blerësi i NSH-së Ndërmarrja e Re “Birraria e Pejës” përveç investimeve dhe punësimit ka pasur edhe kushtin e blerjes së 5,000 ton elb për dy vite brenda periudhës së zotimit. Testet tona nuk kanë hasur në dëshmi për përmbushjen e këtij Zotimi. Dëshmitë e ofruara tregojnë për kontraktimin e 312 tonë elb.

Për më tepër, ne kemi hasur në rreth 350 fatura të akomodimit, për të cilat të dhënat e ofruara nuk kanë qenë të mjaftueshme për të dëshmuar se parat e paguara për to kishin të bënin me konsulent, shpenzime këto që mund t’iu vishen investimeve kapitale.

Vonesë në kthimin e pronësisë për Blerësit me shkallë të ulët të përmbushjes së Zotimit

Sipas “Marrëveshje Zotimi”, Blerësi i lë AKP-së opsionin që AKP-ja të rikthejë të gjithë kapitalin e aksioneve me vlerë nominale. Kthimi i aksioneve do të ushtrohet vetëm pas udhëzimeve me shkrim të BD dhe atë në rastet: një shkelje të rëndë të Zotimeve – kur implementimi i secilit prej Zotimeve nuk do të kalonte 40% gjatë periudhës së zotimit.

Tabela në vijim prezanton Ndërmarrjet, për të cilat BD ka marrë vendim për kthimin e pronësisë sepse Blerësit e tyre kanë pasur një shkallë të ulët të realizimit të Zotimeve.

Tabela 4: Kthimi i pronësisë

Ndërmarrja	Periudha e Zotimit	Zotimi i realizuar për investime (në %)	Zotimi i realizuar për punësim (në %)	Kthimi i pronësisë
Llamkos Steel	21/07/2005-20/07/2007	11.10%	100%	21/05/2008
Xim Stezovci	13/12/2007-13/12/2009	0.96%	4.62%	15/03/2012
Grand Hotel	13/10/2006-12/10/2008	9.84%	100%	31/05/2012
Magnezite Mine Golesh	11/12/2007-11/12/2009	2.02%	16.33%	31/08/2014

Nga tabela e më sipërme vërejmë se BD i AKP-së dy deri në tri vite me vonesë pas përfundimit të periudhës së Zotimit ka marrë vendim për kthimin e pronësisë.

Nga këto katër Ndërmarrje për të cilat janë kthyer pronësitë, objekt i mostrave tona ka qenë vetëm Ndërmarrja “Xim Stezovci”, për shkak se të tjerat ishin nën hetime.

Blerësi i Ndërmarrjes “Xim Stezovci”, brenda periudhës së Zotimit kishte realizuar një shkallë të ulët të investimeve dhe të punësimit, 0.96% përkatësisht 4.62%. Vendimi për tërheqjen e aksioneve kishte hyrë në fuqi dy vjet mbas përfundimit të periudhës.

Si pasojë e këtyre vonesave dhe neglizhencës gjatë periudhës së monitorimit, ishte konstatuar disa herë gjatë vizitave monitoruese se asetet ishin dëmtuar rëndë nga ana e Blerësit. NJKM-ja gjatë vizitës në teren ka vërejtur se ka mospërputhje në mes të listës së aseteve që AKP-ja posedon dhe aseteve që aktualisht ishin në ndërmarrje. AKP-ja për dëmtimin e Ndërmarrjes kishte qenë e informuar edhe nga Këshilli Lokal – Strezovc. Blerësi i Ndërmarrjes në takim me NJKM-në kishte pranuar se i kishte dëmtuar asetet dhe të njëjtat i ka transferuar në Minierën e Goleshit pasi që është i njëjti pronar.

Marrja e vendimeve me vonesë e rritë rrezikun për dëmtim, humbjen apo tjetërsimin e aseteve të Ndërmarrjes.

Vonesat në marrjen e vendimeve për kthimin e pronësisë në rastet kur Zotimet e Blerësve nuk përmbushen rrezikon vazhdimin e afarizmit.

3.3 Deri në çfarë niveli janë përmbushur zotimet nga blerësit?

Përmbushja e plotë e Zotimeve të Blerësve të Ndërmarrjeve Shoqërore ndikon në zhvillimin ekonomik të vendit dhe në rritje të punësimit. AKP-ja duhet të sigurohet që Zotimet për investime dhe punësim janë përmbushur dhe t'i lirojë ata nga monitorimi kur ato të përmbushen 100%.

Një analizë e përgjithshme mbi nivelin e përmbushjes së Zotimeve nga Blerësit e NSH-ve të privatizuara me metodën e spin off-it special siç parashihet me “Marrëveshje Zotimi”, bazohet në krahasimin e të dhënave të nxjerra nga kushtet e Zotimit dhe rezultatet e arritura në momentin e liritimit.

Tabela në vijim prezanton përmbushjen e Zotimeve për Investime dhe Punësim brenda Periudhës së Zotuar dhe rezultatit e arritur në momentin e liritimit.

Tabela 5: Niveli i përmbushjes së Zotimeve për 26 Ndërmarrjet

	Zotimi i Blerësve	Në fund të periudhës së Zotimit	Në %	Rezultatet e arritura ⁶	Në %
Investimet e Zotuara	197,453,564€	90,788,804€	46%	133,568,501€	68%
Punësimi i Zotuar	7,913	6,885	87%	7,595	96%


Nga tabela e më sipërme vërejmë se zotimet e përmbushura brenda periudhës së zotimit ishin në shkallën 46% për investimet, ndërsa 87% për punësimin. Ndërsa rezultatet e arritura të konfirmuara nga auditorët e pavarur për investime arrin në masën prej 68% dhe 96% për punësim.

Grafiku në vijim jep një pasqyrë për rezultatet e arritura sipas numrit të Ndërmarrjeve dhe shkallën e realizmit.⁷

⁶ Rezultatet e arritura nënkupton investimin dhe punësimin e realizuar pas zgjatjeve të periudhës së zotimeve (periudhë e cila ishte e përcaktuar me "Marrëveshje Zotimi").

⁷ Dy Ndërmarrje ende janë nën monitorim.


Grafiku 1: Rezultatet e arritura për Investime



Kushti për privatizimin e 21 Ndërmarrjeve ishte investimi kapital. Sipas grafikut të mësipërm gjashtë nga to kanë arritur Zotimin e tyre në masën 100%.

Nga këto, mund të konkludojmë se, AKP-ja nuk ka arritur të ndikojë që Zotimet e Blerësve të plotësohen tërësisht siç parasheh "Marrëveshje Zotimi".

Përveç Zotimit për investime Blerësit janë zotuar edhe për punësimin e një numri të caktuar punonjësish. Grafiku në vijim jep një pasqyrë për rezultatet e arritura, pas vazhdimëve të periudhës së Zotimit, sipas numrit të Ndërmarrjeve dhe punësimin e realizuar.



Kushti për privatizimin e 25 Ndërmarrjeve ishte punësimi. Sipas grafikut të mësipërm, 21 nga to kanë arritur Zotimin e tyre në masën 100%.

4 Konkluzionet

Rregullimi i monitorimit të kontratave të shitjeve

AKP-ja ka të dizajnuar një sistem monitorimi dhe raportimi. Megjithatë, në planet vjetore të aktiviteteve të monitorimit, AKP-ja, nuk ka vendosur objektivat konkrete në harmoni me kontratat e nënshkuara.

Monitorimi i procesit të përmbushjes së Zotimeve të Blerësve

“Marrëveshje Zotimi” nuk parasheh zgjatjen e periudhës së zotimit, mos vënien e ndëshkimeve kur nuk plotësohen zotimet e marra nga blerësit dhe lirimin e blerësve nga zotimet pa u plotësuar në tërësi ato.

NJKM-ja ka monitoruar përmbushjen e Zotimeve dhe ka ndërmarrë veprime, mirëpo Bordi i Drejtorëve (BD) nuk ka miratuar ndëshkimet në rastin e mos përmbushjes së Zotimeve dhe i ka liruar blerësit edhe në rastet kur zotimet nuk janë përmbushur në tërësi. Andaj mund të konkludojmë se mos miratimi i ndëshkimeve dhe lirimi nga zotimet pa u përmbushur ato janë devijime prej kushteve të Marrëveshjes.

Përmbushja e Zotimeve nga Blerësit e NSH-ve të shitura me metodën e spin off-it special

Përmbushja e Zotimeve për Investime nga ana e Blerësve brenda periudhës së Zotuar ishte realizuar në shkallë nën 50%, ndërsa rezultatet e arritura deri më tani pas zgjatjes së periudhës për përmbushje të zotimeve janë afërsisht në masën 70%. Rezultatet e arritura për zotimet për punësim janë të kënaqshme, dhe deri më tani kanë arritur deri në nivelin 96%.

5 Rekomandimet

Rezultatet tregojnë se ekziston se AKP ka hapësirë për përmirësim në fushën e monitorimit.

Me qëllim të shfrytëzimit të mësimave të nxjerra nga procesi i privatizimit në të ardhmen, ne rekomandojmë:

Bordin e ardhshëm të AKP-së të sigurojë që:

1. Planet vjetore të monitorimit të jenë të lidhura me objektivat konkrete në kontratat e nënshkruara.
2. Procesi i monitorimit të përmbushjes së Zotimeve të plotësohet duke shfrytëzuar fuqishëm masat e përcaktuara në rastet kur kushtet nuk përmbushen siç parashihet me “Marrëveshje Zotimi”.
3. Të shtohet presioni tek Blerësit e Ndërmarrjeve që t’i përmbushin zotimet e bëra dhe që blerësit të lirohen nga këto zotime kur ato të jenë plotësuar tërësisht.

Ne rekomandojmë Qeverinë:

1. Mësimet e nxjerra nga proceset aktuale të monitorimit ti marrë parasysh në proceset e ardhshme të privatizimit.